



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

STRATEGJIA PËR KËRKIMIN SHKENCOR E
DEPARTAMENTIT TË GJUHËVE TË HUAJA
(2017-2020)

Hartuar nga Grupi për Strategjinë e DGJH-së në përputhje me Ligjin për Arsimin e
Lartë nr. 80/2015

Hyrje

Plani strategjik i DGJH-së për 2017-2020 është konceptuar duke u nisur nga veçantitë, përvojat e mira dhe sukseset e deritanishme të departamentit, duke u frymëzuar nga përvojat e mira botërore në kërkim, si dhe duke marrë parasysh sfidat e reja në kërkim në planin kombëtar dhe ndërkombëtar për t'iu përgjigjur në mënyrë sa më koherente dhe efikase vizionit dhe misionit të UV-së të orientuar drejt ndërkombëtarizimit, si dhe nevojës për të kapërcyer ndarjet klasike disiplinore dhe për të përqafuar njohuri dhe ekspertizë komplementare nga fusha të tjera në mënyrë që t'i përgjigjemi sa më mirë një mjedisi gjithnjë e më kompleks.

Ky dokument paraqet vizionin dhe misionin e DGJH-së për kërkimin shkencor, identifikon fushat kryesore të kërkimit në DGJH, arritjet e synuara në kërkim, planin e veprimit për zbatim për periudhën 2017-2020.

Vizioni dhe misioni i veprimtarisë kërkimore-shkencore të DGJH-së

Vizioni i DGJH-se për kërkimin shkencor për 2017-2020 është krijimi i një mjedisi nxitës për ekselencë në kërkim, mbështetje për kërkuesit dhe studiuesit, sidomos kërkuesit e rinj, përmes përmirësimit të kushteve dhe faciliteteve kërkimore me synimin e çuarjes përpara dhe zbatimin e njohurive të reja.

Misioni i DGJH-se është të luajë rolin e vet në kthimin e UV-së në një universitet aktiv në kërkim, në qendër rajonale zhvillimi, në faktor të rëndësishëm për rritjen e përgjegjësisë publike në kërkim dhe afrimin e universitetit me komunitetin, në hapjen e kërkimit të zhvilluar në UV ndaj publikut të gjerë dhe në shërbim të komunitetit, në kthimin e UV-së në mjedis nxitës dhe mbështetës për kërkim për studentët aktualë dhe kërkuesit e rinj, në rritjen e vizibilitetit të kërkimit në UV brenda dhe jashtë vendit.

Synimet

Në linje me vizionin dhe misionin e UV-së, që synojnë në tërësi ndërkombëtarizimin e UV-së, synimet tona lidhen me:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- Mbështetjen dhe nxitjen e kërkimit (bazë dhe të zbatuar) përmes formave të ndryshme të shpërndarjes së informacionit dhe kanaleve të informimit dhe burimeve dhe mjeteve financiare të mundshme në dispozicion.
- Afrimin e kërkimit me shoqërinë dhe komunitetin përmes qasjes RRI (*Responsible Research and Innovation* – Kërkim dhe Inovacion i Përgjegjshëm), që nënkupton përfshirjen e gjithë aktorëve shoqërorë në proces për të bërë bashkë vetë procesin dhe rezultatet e tij me pritshmërinë, vlerat dhe nevojat e shoqërisë.
- Krijimin e një mjedisi nxitës për ekselencë në kërkim duke inkurajuar dhe mbështetur kërkimin në të gjitha nivelet, që nga studentët e të gjitha cikleve deri tek kërkuesit me përvojë dhe gjithë aktoret e tjerë komunitarë pjesëmarrës në kërkim.
- Ndërdisiplinarizimin e kërkimit shkencor duke përqafuar njohuri dhe ekspertizë komplementare nga fusha të tjera që kontribuojnë në njohuritë nga fushat tradicionale: shkencat gjuhësore, studimet letrare dhe kulturore si dhe metodologji e mësimdhënies.
- Thellimin e bashkëpunimeve ekzistuese me institucione partnere në kërkim.
- Krijimin e lidhjeve, bashkëpunimeve dhe partneriteteve të reja me aktorë të ndryshëm vendas, rajonalë dhe më gjerë në funksion të përfitimit të ndërsjellët.
- Nxitja e lëvizjes së kërkuesve për shkëmbim përvojash.
- Mbrojtje e të drejtave të kërkuesve duke u mbështetur në parimet e Kartës Evropiane të Kërkuesve.
- Orientimin e programeve të studimit drejt komponentit të kërkimit shkencor.
- Forcimit dhe rritjes të kapaciteteve njerëzore në kërkim.

Prioritetet strategjike

1. *Ndërthurja e kërkimit me arsimimin:* Në këtë kuadër DGJH do të orientohet drejt nxitjes dhe mbështetjes të integritit të kërkimit në programet mësimore me qëllim krijimin e mundësive të nxisin të mësuarin, por mbi të gjitha, pasqyrojnë ndikimin jetësor të kërkimit.
2. *Zgjerimi i partneritetit dhe bashkëpunimit:* Theksi i veçantë do t'i vihet partneritetit dhe bashkëpunimit, sidomos në kuadër projektsh kërkimore dhe zhvillimore për të sjellë mundësi të reja për kërkim, për t'u përfshirë me partneret komunitarë, për të përçarur dijen në komunitet dhe shoqëri, si dhe për të nxitur iniciativat dhe sipërmarrjet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

3. *Përmirësimi dhe krijimi i kushteve për kërkim:* Kjo nënkupton investime në facilitete dhe burime njerëzore kryesisht përmes thithjes së fondeve dhe granteve për kërkim dhe krijimin e mundësive për trajnime të stafit.
4. *Drejt ekselencës në kërkim:* Ky prioritet është i integruar praktikisht në prioritet e tjera. Mënyra më e mirë për ta arritur këtë është respektimi i parimeve të Kartës Evropiane të Kërkuesve.

Fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore (bazë dhe të zbatuar)

Veprimtaria kërkimore-shkencore e DGJH-së ndërthet katër fusha kryesore, secila prej të cilave përfshin tematika bashkëkohore si vijon:

1. Studime/shkenca gjuhësore
 - Teori gjuhësore
 - Variacionet dhe ndryshimet gjuhësore
 - Evoluimi, mësimi dhe zhvillimi i gjuhës
2. Studime letrare
 - Letërsia e mesjetës
 - Studime për teatrin
 - Letërsia për fëmijë
 - Letërsia ballkanike
 - Letërsia e luftës
 - Letërsia e udhëtarit
 - Prirje të letërsisë post-moderne
3. Studime kulturore
 - Studime anglofone/italofone
 - Studime ballkanike
 - Studime gjinore
 - Studime të medias
 - Studime të filmit
4. Edukim dhe mësimdhënie e gjuhës së huaj
 - Përvetësimi i gjuhës
 - Ndërthurja e teknologjisë me mësimdhënien
 - Gjuhësi e aplikuar
 - Bilinguizmi/multinguizmi

Realizimi i prioriteteve strategjike

Prioritetet strategjike	Synimet	Hapat që do të
--------------------------------	----------------	-----------------------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

		ndërmerren
Ndërthurja e kërkimit me arsimimin	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një mjedisi nxitës për ekselencë në kërkim duke inkurajuar dhe mbështetur kërkimin në të gjitha nivelet, që nga studentët e të gjitha cikleve deri tek kërkuesit me përvojë dhe gjithë aktorët e tjerë komunitarë pjesëmarrës në kërkim. • Thellim i bashkëpunimeve ekzistuese me institucione partnere në kërkim • Orientim i programeve të studimit drejt komponentit të kërkimit shkencor • Ndërdisciplinarizimi i kërkimit shkencor duke përqafuar njohuri dhe ekspertizë komplementare nga fusha të tjera që kontribuojnë në njohuritë nga fushat tradicionale: shkencat gjuhësore, studimet letrare dhe kulturore si dhe metodologji e mësimdhënies 	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikim dhe vlerësim i brendshëm i programeve mësimore • Kërkim i tregut të punës • Konsultim me dokumentet evropiane për strategjitë e arsimit dhe kërkimit • Konsultim me programe të ngjashme të ofruara nga departamente simotra brenda dhe jashtë vendit • Përfshirje e studenteve në aktivitete kërkimore • Bashkëpunim me njësi të tjera akademike dhe kërkimore për përfshirjen e studenteve në kërkim • Organizim aktivitetesh shkencore (konferenca, seminare, botime) për studentët ose me përfshirje të studentëve
Zgjerimi i partneritetit dhe bashkëpunimit	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje dhe nxitje e kërkimit (baze dhe te zbatuar) përmes formave të ndryshme të shpërndarjes së informacionit dhe kanaleve të informimit dhe burimeve dhe mjeteve financiare të mundshme në dispozicion • Thellim i bashkëpunimeve ekzistuese 	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunim i ngushtë me Sektorin e Kërkimit Shkencor (UV) dhe Drejtorinë e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, UV • Vendosje e pikave të kontaktit me këto zyra • Aplikim për fonde kërkimi pranë AKKSHI-it



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	<p>me institucione partnere në kërkim.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i lidhjeve, bashkëpunimeve dhe partneriteteve të reja me aktore të ndryshëm vendas, rajonalë dhe më gjerë në funksion të përfitimit të ndërsjellët. • Nxitje e lëvizjes së kërkuesve për shkëmbim përvojash • Rritje e profilit të departamentit brenda dhe jashtë vendit 	<ul style="list-style-type: none"> • Aplikim në projekte evropiane (Horizon 2020, ERC grants etj.) • Aplikime në kuadër të programit Erasmus apo programeve të tjera që nxisin mobilitetet e stafit • Organizim ditësh informimi për thirrje të ndryshme • Informim përmes kanaleve të ndryshme • Organizim i aktiviteteve shkencore dhe botimeve të përbashkëta me universitete partnere • Njohja me Rrjetin Euraxess dhe nxitje e kërkuesve për t'u regjistruar në të për të marrë më shumë informacion për mundësitë për kërkim dhe mobilitet • Zgjerimi i <i>network</i>-ut të bashkëpunimit përmes iniciativave të ndryshme
<p>Përmirësimi dhe krijimi i kushteve për kërkim</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Forcimi i kapaciteteve njerëzore në kërkim • Krijimi i kushteve logjistike për kërkim 	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritje, përmirësim, zgjerim i bazës logjistike në kërkim përmes fondeve të brendshme dhe aplikimeve për grante apo projekte përmes skemave dhe programeve të ndryshme financimi për kërkimin • Rritje e mobiliteteve për trajnim përmes aplikimeve për projekte



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

		<ul style="list-style-type: none">• Afrimi i studentëve ekselentë dhe përfshirje e tyre në projekte kërkimore dhe aplikime
Drejt ekselencës në kërkim	<ul style="list-style-type: none">• Afrimi i kërkimit me shoqërinë dhe komunitetin përmes qasjes RRI (<i>Responsible Research and Innovation</i> – Kërkim dhe Inovacion i Përgjegjshëm• Respektimi i parimeve të Kartës Evropiane të Kërkuesve• Cilësi e punimeve dhe botimeve shkencore	<ul style="list-style-type: none">• Hartimi i planeve vjetore për kërkimin• Rritja e cilësisë së aplikimeve në projekte kërkimore përmes asistencës nga zyrat përkatëse brenda UV-së, vjeljes së mendimeve nga partnerë lokalë, rajonalë dhe më gjerë.• Ngritja e një komisioni departamenti për shqyrtimin dhe asistimin në shkrim projektsh kërkimore si dhe për vlerësimin e etikës në kërkim• Rritja e bashkëpunimit me aktorët e ndryshëm shoqërorë për ta bërë kërkimin më të përgjegjshëm• Identifikim i nevojave të kërkuesve• Përfshirja në kërkim e aktorëve lokalë jashtë universitetit• Publikimi i arritjeve në kërkim në një lidhje të dedikuar në faqen e DGJH-së• Informim i stafit për organet dhe revistat serioze dhe të indeksuara ku mund



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

		të publikojnë rezultatet e kërkimit të tyre
--	--	---

Matja e arritjeve

Matja e arritjeve do të kryhet përmes

- identifikimit të dobësive, mundësive dhe pikave të forta për të planifikuar fushat dhe prioritet në kërkim me vijimësi. Mjetet e përdorura do të jene vëzhgimet, pyetësorët, intervistat me stafin dhe studentet.
- identifikimit të treguesve kryesore të performancës dhe një sërë mjetesh të tjera matëse për të parashtruar nevojat tek drejtuesit e UV-së, si dhe për të orientuar buxhetin për kërkimin. Për këtë do të bazohemi kryesisht tek praktika të mira botërore.
- Vendosja e një sistemi menaxhimi të performances në kërkim, e cila do të synojë matjen e arritjeve të vendosura në fillim të vitit nga stafi dhe realizimin e tyre në fund të vitit. Kjo do të kryhet përmes një modeli të gatshëm, ku do të radhiten qëllimet/treguesit e performancës, të cilat më pas do të verifikohen dhe shënjoohen.